

INVESTIMI NË LAGJEN 5 KAMËZ

Rruga "Faik Halil Hoxhaj", me parametra bashkëkohorë



FAQE **3**

SOCIALE

Bashkëpunimi i Bashkisë Kamëz me "Qatar Charity", ndihma për familjet në nevojë



FAQE **8**

SHËRBIME

Drejtorja e Taksave dhe e Tarifave Vendore, e motivuar për të realizuar objektivat



FAQE **7**

NË PALLATIN E KULTURËS KAMËZ

Shfaqja "Bon-Boni në mbretërinë e ëmbëlsirave", me pjesëmarrjen e Marjana Kondit



FAQE **7**



Gazetë e Bashkisë Kamëz
KAMZA

E përdyjavshme
Nr. 215 qershor 2018
Çmimi 20 lekë
drmediakamez@gmail.com
www.kamza.gov.al

Intervista e kryebashkiakut Xhelal Mziu për "Starpeople"

MISIONI IM PËR KAMZËN

FAQE 4-5

Vijojnë punimet në sheshin e ri në qendër të qytetit

FAQE 6

Kanalizimet në rrugën "Hasi", Valias, me gjatësi 950 metra linearë, investim me impakt të jashtëzakonshëm

FAQE 3

Ndërmarrja e Ujësjetës-Kanalizimeve vlerësohet nga KfW lidhur me auditin financiar për fazën V të projektit të ujësjetës

FAQE 7

Asambleja e Rajoneve Evropiane, AER, publikon kërkesën e Bashkisë Kamëz për partneritet në projekte

FAQE 8



Xhelal Mziu është ndër liderët fjalëpak. Pak gjëra mund t'i marrin vëmendjen e tij, por kjo deri kur përmendet Kamza. Kur flasim për qytetin që ai drejton prej 11 vitesh, kryebashkiaku ka shumë për të thënë. Investimet, projektet, idetë, problemet e këtij qyteti marrin menjëherë të gjithë përkushtimin e tij dhe ka shumë për të thënë. Duket se ky qytet, fare pranë Tiranës, po ndryshon me ritme të shpejta dhe ky është misioni që Xhelal Mziu ka pasur dhe ka këto 11 vite në postin e Qytetarit të Parë. Në intervistën e tij për "Starpeople", kryebashkiaku rrëfen impenjimet dhe sfidat që ndesh çdo ditë. Por krahas kësaj, Mziu rrëfen për lexuesin edhe anën tjetër, si një njeri familjar dhe një prind i përkushtuar...

Ndërtimi i rrugës "Abdi Bej Toptani" në Valias, 1.4 km e gjatë, investim themelor i Bashkisë

FAQE 2



NË BRENDËSI

Kryebashkiaku Mziu, i ftuar në panelin 2 të programit "Bashkitë/qytetet urbane inteligjente dhe industrinë e energjisë 2018"

FAQE 8

Ndërtohen kanalizimet pranë shkollës "Tahir Sinani", investim i financuar nga Bashkia Kamëz

FAQE 2

Takim në kuadër të projektit "Rrisim kapacitetet e ofruesve të shërbimeve për gratë viktimat të të gjitha formave të dhunës"

FAQE 8

Përfundon procedura e prokurimit, lidhet kontrata për nisjen e ndërtimit të rrugës "Myslym Shyri" në Babrru

FAQE 6

Punonjësit e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjellbërimit, të fokusuar në punën për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit

FAQE 7



Ndërtimi i rrugës “Abdi Bej Toptani” në Valias, 1.4 km e gjatë, investim themelor i Bashkisë

Është hedhur shtresa e asfaltit në rrugën “Abdi Bej Toptani” në Valias, 1.4 km e gjatë. Falë investimit të Bashkisë Kamëz, kjo rrugë po kthehet në një segment me parametra bashkëkohorë. Nisur nga kërkesat e shumta të banorëve të zonës, Bashkia pati hartuar projektin për ndërtimin e rrugës, ndërsa tani është drejt përfundimit, duke qenë kështu një tjetër investim i dobishëm jo vetëm për këtë zonë, por për të gjitha ata qytetarë që zgjedhin të kalojnë përgjatë këtij segmenti. Rruga “Abdi Bej Toptani” është e gjatë 1.4 km, gjerësi 10 ml, me kuletë 0.5 ml dhe trotuare në të dyja anët e rrugës me nga 2



ml gjerësi. Realizimi i këtij investimi themelor ndikon jo vetëm në lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe automjeteve, por i jep shtysë edhe zhvillimit të bizneseve, duke qenë një nga rrugët kryesore të Kamzës dhe që bën lidhjen e disa lagjeve të këtij qyteti ndërmjet tyre, por edhe me zonat përreth.

Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën “Strasburgu” lagjen nr. 2 Kamëz, investim me rëndësi për banorët e zonës



Ndërtimi i kanalizimeve në rrugën “Strasburgu” lagjen nr. 2 Kamëz është një investim me rëndësi për banorët e zonës. Projekti për ndërtimin e KUN në rrugën “Strasburgu” bën pjesë në investimet e realizuara gjatë dy viteve të fundit nga Bashkia Kamëz, në një situatë të vështirë, për shkak të mosfinancimit të projekteve nga ana e qeverisë. Zbatimi i këtij projekti u ka dhënë zgjidhje shumë problematikave dhe shqetësimeve të banorëve të zonës. Një prej këtyre shqetësimeve ka qenë edhe ndërtimi i kanalizimeve, tashmë i zgjidhur me realizimin e investimit të Bashkisë financiar nga të ardhurat e veta. Gjatësia e segmentit rrugor është 345 metra linearë, ku janë përdorur tuba me përmasa Ø 400 mm. Bashkia Kamëz, si institucioni që ka lidhje të drejtpërdrejta me qytetarët dhe problematikën e tyre, ka hartuar dhjetëra projekte. Një ndër to është edhe ndërtimi i kanalizimeve në Kamëz dhe Paskuqan. Ashtu si vitet e mëparshme, investimet publike vijnë të jenë në qendër të punës dhe angazhimeve të Bashkisë, e cila ka bërë të mundur dhjetëra projekte me ndikim të jashtëzakonshëm social.

Ndërtohen kanalizimet pranë shkollës “Tahir Sinani”, investim i financiar nga Bashkia Kamëz



Bashkia Kamëz ka realizuar një tjetër investim për qytetarët e saj. Bëhet fjalë për ndërtimin e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura pranë shkollës “Tahir Sinani” në Kodër të Kuqe. I gjithë projekti është financuar vetëm nga të ardhurat e Bashkisë.

Ndërtimi i kanalizimeve pranë shkollës “Tahir Sinani” është një tjetër investim i Bashkisë Kamëz me rëndësi të madhe për komunitetin. Projekti bën pjesë në investimet e vitit 2018, që financohen nga buxheti i Bashkisë, në një kohë kur

nga ana e qeverisë ka pasur vetëm diskriminim dhe indiferencë në këtë drejtim. Ndërtim i kësaj KUN-je, me gjatësi 180 ml, merr një vlerë më të madhe për arsye se ndodhet pranë një objekti arsimor, siç është shkolla “Tahir Sinani”. Ndërkaq, në planin e Bashkisë për vitin 2018 është edhe rikonstruksioni i kësaj shkolle, por edhe i objekteve të tjera arsimore. Në këtë mënyrë, projektet zhvilluese do të përfshijnë disa fusha jetikë për qytetin dhe qytetarët e Kamzës.

Investime pa fund në infrastrukturën e qytetit, ndër to ndërtimi i KUN te rruga “Kukësi” në Valias, me gjatësi 850 metra linearë



Investimet e Bashkisë Kamëz në infrastrukturën e qytetit mund të thuhet se janë pa fund. Duke marrë si pikë nisjeje vitin 2007 e deri këtë vit janë me qindra projekte të hartuara e të zbatuara në këtë qytet. Gjendja aktuale me periudhën e mëparshme e Kamzës është e pakrahasueshme, me rrugë të reja, ujësjellës, kanalizime, shkolla, kopshte, pallat kulture, palestra, qendra sociale etj., të cilat i kanë dhënë pamjen e një qyteti modern. Një nga këto investime është edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve te rruga “Kukësi” në Valias, me gjatësi 850 metra linearë. Një investim shumë i dobishëm për banorët, me impakt të jashtëzakonshëm social, duke qenë se zgjidh një problematikë të mprehtë, siç janë kanalizimet e ujërave të ndotura. Në KUN-në e rrugës “Kukësi”, me gjatësi 850 metra linearë, janë përdorur tuba me përmasa Ø 600 mm në segmentin kryesor dhe Ø 800 mm në derdhjen e tij. Projekti është financuar nga të ardhurat e vetë Bashkisë, pasi qeveria, që duhet të ishte e të gjithë shqiptarëve, qytetarët e Kamzës i ka lënë në harresë, duke mos akorduar asnjë qindarkë për projektet e gatshme të Bashkisë, të cilat janë konkurruese dhe me standarde bashkëkohore.

Ndërtimi i KUN në rrugën “Bernë”, lagjja 4 Kamëz, investim i Bashkisë drejt përfundimit



Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën “Bernë”, lagjja nr. 4 Kamëz, është investim i Bashkisë, punimet e të cilit janë drejt përfundimit. Me gjatësi 345 metra linearë, në këtë projekt janë përdorur tuba me përmasa Ø 400 mm. KUN te rruga “Bernë” është një investim i vitit 2018, me ndikim të madh për banorët e zonës. Bashkia kishte planifikuar që nëpërmjet të ardhurave të veta të parashikuar në buxhetin e këtij viti të ndërtonte edhe rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura në rrugën “Bernë”, që shtrihet në lagjen nr. 4 Kamëz. Ndikimi që sjell realizimi i projektit është i jashtëzakonshëm, pasi u vjen në ndihmë qindra familjeve të zonës, duke përmirësuar infrastrukturën e kanalizimeve, si dhe duke shmangur ndotjen e mjedisit. Me fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2018, Bashkia Kamëz po realizon edhe këtë projekt jetik për banorët, pasi me përfundimin e tij merr zgjidhje një prej problemeve shqetësuese të qytetarëve. E gjitha kjo bëhet me të ardhurat e vetë Bashkisë, e cila duke parë indiferencën dhe diskriminimin e qeverisë për pesë vjet me radhë, ka qenë e detyruar të shfrytëzojë çdo burim të mundshëm për të financuar projektet në infrastrukturën urbane të qytetit.

Një tjetër rrjet kanalizimesh ndërtohet në Babrru nga Bashkia Kamëz, KUN në rrugën “Petro Nini Luarasi”



Një tjetër rrjet kanalizimesh është ndërtuar në Babrru nga Bashkia Kamëz. Bëhet falë për rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN) në rrugën “Petro Nini Luarasi”. Segmenti në të cilin ka investuar Bashkia është i gjatë 150 metra linearë, ku janë përdorur tuba me përmasa Ø 300 mm. Ky është një ndër 70 projektet e reja që po realizohen gjatë këtij viti. Të gjitha këto projekte janë pjesë e buxhetit të Bashkisë, e cila duke parë indiferencën e qeverisë shqiptare për investime në Kamëz, ka parashikuar që t'i financojë vetë ato. Kjo është arritur falë mirëmenaxhimit të të ardhurave, falë politikave lehtësuese të Bashkisë për qytetarët dhe bizneset. Gjithashtu, edhe partneriteti me donatorë të huaj ka bërë që të realizohen dhjetëra projekte të rëndësishme, siç është partneriteti me Bankën Botërore, USAID-in, qeverinë gjermane, KfW etj. Bashkia Kamëz është e vendosur që të vijojë me ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët dhe me investime të tjera, pavarësisht nga situata jo e favorshme e diktuar nga kjo qeveri diskriminuese.



Rruga "Faik Halil Hoxhaj", një investim i Bashkisë me parametra bashkëkohorë në lagjen nr. 5 Kamëz

Qershor 2018
GAZETA KAMZA



3

Rruga "Faik Halil Hoxhaj" është një investim i rëndësishëm i Bashkisë me parametra bashkëkohorë në lagjen nr. 5 Kamëz. Investimi i financuar me të ardhurat e vetë Bashkisë ka një gjatësi prej 660 metrash linearë, i ndarë në dy segmente: segmenti i parë me gjatësi 395 metra linearë, gjerësi 5 m, 2 x 0.5 m kunetë dhe 2 x 1.5 m trotuare, që do të thotë me një gjerësi 9 ml përfshirë komponentët e sipërpërmendur; segmenti i dytë me gjatësi 265 metra linearë, 5 m gjerësi asfalti dhe 2 x 0.5 m bankinë.

Ky është një investim që i është përshtatur terrenit me të gjithë parametrat bashkëkohorë, duke përfshirë edhe ndriçimin e rrugës.

Ndërtimi i rrugës "Faik Halil Hoxhaj" është një prej dhjetëra investimeve të realizuara nga Bashkia Kamëz në këtë lagje, ku janë ndërtuar rrugë, kanalizime, shkolla etj. Megjithatë, ky investim nuk do të jetë i fundit, pasi Bashkia vit pas viti do të hartojë dhe do të zbatojë projekte në infrastrukturë dhe fusha të tjera jetike për qytetarët e Kamzës.



Kanalizimet në rrugën "Hasi", Valias, me gjatësi 950 metra linearë, investim me impakt të jashtëzakonshëm



Rrjeti i kanalizimeve në rrugën "Hasi", Valias, me gjatësi 950 metra linearë, përbën një investim me impakt të jashtëzakonshëm për banorët e zonës. Ky projekt është financuar nga buxheti i Bashkisë Kamëz. Në KUN e rrugës "Hasi" janë përdorur tuba me përmasa Ø 600 mm, Ø 500 mm dhe Ø 315 mm. Ky investim i rëndësishëm është realizuar për shkak të problematikave që shkaktonte te banorët e asaj zone mungesa e tij. Në bazë të kërkesave të banorëve të Valiasit, nga Bashkia Kamëz u pa e nevojshme të ndërtohej rrjeti i KUN-së në rrugën "Hasi", duke realizuar kështu projekt të rëndësishëm në drejtim të ofritit të një infrastrukture të dobishme dhe bashkëkohore për qytetarët. Bashkia vijon të financojë e vetme të gjitha investimet për pesë vite me radhë, për shkak se qeveria ka diskriminuar dhe po diskriminon ende qytetarët dhe Bashkinë e Kamzës, duke mos akorduar asnjë fond për ta.

Kanalizimet në rrugën "Isuf Xhelili" në Paskuqan 2, Kodër, investim i realizuar nga të ardhurat e Bashkisë



Kanalizimet në rrugën "Isuf Xhelili" në Paskuqan 2, Kodër, është një investim i realizuar nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz. 480 metra linearë është gjatësia e segmentit në rrugën

"Isuf Xhelili", ku Bashkia ka ndërtuar rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura (KUN). Kjo rrugë shtrihet në lagjen Paskuqan 2, Kodër. Në këtë KUN janë përdorur tuba me përmasa Ø 315 mm dhe Ø 400 mm. Me realizimin e këtij projekti për banorët e zonës merr zgjidhje një problematikë dhe shqetësim lidhur me ndërtimin e infrastrukturës. Meqenëse kërkesat dhe nevojat e komunitetit janë të shumta dhe emergjente, Bashkia Kamëz i është drejtuar për pesë vite rresht qeverisë për financim projektesh, por këto kërkesa kanë rënë në vesh të shurdhër. Duke u gjendur përballë kësaj situatë, Bashkia ka shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme për t'u ofruar qytetarëve të saj investime publike dhe shërbime cilësore. Ndërkohë që pjesa më e madhe e rrugës "Isuf Xhelili" është ndërtuar nga Bashkia Kamëz, me të ardhurat e veta gjatë vitit të kaluar, këtë vit objekt i investimit të Bashkisë ishte ndërtimi i KUN-së, një investim tashmë i realizuar.

Mes investimeve të realizuara të Bashkisë, ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Buenos Aires" dhe "Montekarlo" në lagjen nr. 4 Kamëz



Mes investimeve të realizuara të Bashkisë është edhe ndërtimi i kanalizimeve në rrugën "Buenos Aires" dhe "Montekarlo" në lagjen nr. 4 Kamëz. Ashtu si në çdo lagje të qytetit, edhe në lagjen nr. 4 të Kamzës Bashkia ka krijuar

një infrastrukturë bashkëkohore dhe do të vijojë edhe më pas që të ofrojë investime në dobi të qytetarëve. I tillë është edhe ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve në rrugën "Buenos Aires" dhe "Montekarlo". Njësoj si edhe të gjitha investimet e këtyre pesë viteve, edhe KUN-të në rrugët "Buenos Aires" dhe "Montekarlo" janë realizuar me të ardhurat e vetë Bashkisë, duke qenë se qeveria nuk ka akorduar asnjë qindarkë për ndërtimin e infrastrukturës së qytetit të Kamzës dhe për asnjë projekt tjetër. Ndërtimi i kanalizimeve në rrugët "Buenos Aires" dhe "Montekarlo" është një investim i rëndësishëm për banorët e zonës. Dy rrjetet e kanalizimeve janë pjesë e investimeve në infrastrukturën urbane. Përfundimi i dy projekteve të mësipërme jep impakt të jashtëzakonshëm. KUN e rrugës "Buenos Aires" është e gjatë 340 ml dhe me tuba të përmasave Ø 300 mm. KUN në rrugën "Montekarlo" ka një gjatësi prej 467 ml me tuba të përmasave Ø 400 mm; Ø 600 mm, Ø 800 mm.

Kanalizimet pranë shkollës "Halit Coka" në Bathore, investim me ndikim të madh në infrastrukturë



Ndërtimi i kanalizimeve pranë shkollës 9-vjeçare "Halit Coka" në lagjen Bathore 3 është një investim i Bashkisë Kamëz që ka ndikuar në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve për qytetarët. Gjatësia e segmentit ku ka investuar Bashkia e Kamzës është 325 metra linearë, ku janë përdorur tuba me përmasa Ø 500 mm. Ky segment kufizohet nga rrugët "Gjallica" dhe "2 Prilli". Mes dhjetëra projekteve që ka realizuar Bashkia në këto vite është edhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura pranë palestrës dhe shkollës 9-vjeçare në lagjen Bathore 3. Ky projekt është financuar tërësisht nga buxheti i Bashkisë. Ndërtimi i KUN-së në këtë zonë i shërben një numri të konsiderueshëm banorësh. Përveç kësaj ky investim shkon në funksion edhe të objekteve shkollore që gjenden aty pranë, siç janë shkollat dhe kopshtet.

KUN në rrugën "Burimi", lagjja nr. 5 Kamëz, në radhën e dhjetëra investimeve me ndikim të madh social



Kanalizimet e rrugës "Burimi" në lagjen nr. 5 Kamëz bëjnë pjesë në radhën e dhjetëra investimeve të Bashkisë me ndikim të madh social për komunitetin e banorëve të zonës. Me gjatësi 725 metra linearë, ku janë përdorur tuba të përmasave Ø 400 mm dhe 600 mm, ky investim u vjen në ndihmë qindra familjeve të lagjes nr. 5 Kamëz. I gjithë projekti është financuar nga buxheti i Bashkisë, me të ardhurat e të cilit janë parashikuar të financohen të gjitha investimet në qytetin e Kamzës. Gjatë dy viteve të fundit, në këtë lagje është investuar kryesisht në rrugë dhe kanalizime, meqenëse ka pasur kërkesa dhe shqetësime të banorëve, të cilat Bashkia i ka marrë parasysh, duke vendosur prioritetet për investimet më emergjente. Kjo, për arsye se vijon diskriminimi i qeverisë ndaj qytetarëve dhe Bashkisë së Kamzës, duke mos akorduar asnjë qindarkë për realizimin e projekteve jetike për komunitetin. E gjendur përballë kësaj situatë, Bashkia me anë të mirëmenaxhimit të të ardhurave ia ka dalë që të financojë vit pas viti projektet për urbanizimin e mëtejshëm të qytetit.



Xhelal Mziu: Misioni im për Kamzën

Xhelal Mziu është ndër liderët fjalëpak. Pak gjëra mund t'i marrin vëmendjen e tij, por kjo deri kur përmendet Kamza. Kur flasim për qytetin që ai drejton prej 11 vitesh, kryebashkiaku ka shumë për të thënë. Investimet, projektet, idetë, problemet e këtij qyteti marrin menjëherë të gjithë përkushtimin e tij dhe ka shumë për të thënë. Duket se ky qytet, fare pranë Tiranës, po ndryshon me ritme të shpejta dhe ky është misioni që Xhelal Mziu ka pasur dhe ka këto 11 vite në postin e Qytetarit të Parë. Në intervistën e tij për "Starpeople", kryebashkiaku rrëfen impenjimet dhe sfidat që ndesh çdo ditë. Por krahas kësaj, Mziu rrëfen për lexuesin edhe anën tjetër, si një njeri familjar dhe një prind i përkushtuar...

Q: Kaq vite nën drejtimin tuaj, sa ka ndryshuar Kamza?

Kamza ka pësuar ndryshime rrënjësore. Unë jam zgjedhur si kryetar i Bashkisë në vitin 2007. Kur u ula në karrigen e kryebashkiakut, situata ishte krejt tjetër nga realiteti i sotëm. Është bërë një punë e madhe në Kamzë 11 vitet e fundit dhe në Paskuqan prej vitit 2015, kur kjo Njësi Administrative na u bashkua.

Për të numëruar arritjet do të duheshin shumë faqe të revistës suaj, por po numërojmë telegrafisht disa prej tyre. Miratua ndër të parët planin urbanistik. Sot jemi qyteti i vetëm me sistem të plotë adresash ku kemi emërtuar mbi 505 rrugë dhe Kamza është gati për implementimin e ZIP-KOD-it. Kemi mundësuar asfaltimin e qindra e qindra km rrugë si dhe rrjet të ujësjellës-kanalizimeve, duke përmirësuar ndjeshëm furnizimin me ujë të pijshëm.

Është mbyllur faza e parë të projektit të ujësjellës-kanalizimeve nga banka gjermane KfW. Së shpejti fillon zbatimi i fazave të tjera. Aktualisht, mbi 70% e popullsisë kanë rrjet të ri ujësjellës dhe furnizim me ujë. Kemi mundësuar edhe shtrirjen e rrjetit të furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike 20 kv mbi 70% të popullsisë. Janë ndërtuar 18 objekte shkollore (shkolla dhe kopshte) me standarde evropiane.

Bashkia ka ndërtuar Pallatin modern të Kulturës, një nga më të mirët në vend, për të rinjtë dhe të gjithë qytetarët. U ndërtua stadiumi i qytetit si dhe palestra moderne e basketbollit në Bathore. Është ngritur qendra e shërbimeve ndaj qytetarëve, One Stop Shop, më e mira në Shqipëri, e vlerësuar nga ndërkombëtarët si praktika më e mirë e qeverisjes vendore.

Është 4-fishuar numri i bizneseve falë taksave të ulëta dhe klimës së mirë që kemi krijuar, gjë që na ka mundësuar edhe punësimin e mijëra qytetarëve. Bashkia Kamzë ka pasur dhe ka një paketë fiskale konkurruese dhe stimuluese për zhvillimin e biznesit, gjë që ka çuar në rritjen e numrit të të punësuarve me mbi 10 mijë veta, ku një ndihmë ka dhënë sektori fason.

Të ardhurat e Bashkisë janë mbi 10-fishuar krahasuar me vite më parë. Kamza sot është një qytet i pastër, me makineri pastrimi bashkëkohore dhe kontejnerë të standardeve evropiane.

Mundësua shtrirjen e linjës së telefonisë fikse dhe internetit në gjithë territorin e Kamzës; ndërtuam rrugën "Demokracia" 7 km të gjatë nga Ura e Institutit në Babrru deri te Kafja e Rremës etj. Të tjera projekte janë në zbatim, jo vetëm për ndërtimin e qindra km rrugë dhe KUN-ve, por edhe qendra e qytetit të Kamzës bashkë me pedonalen që janë në zbatim e sipër, si dhe është bërë rehabilitimi i qendrës së Babrrusë etj. Një punë e madhe është bërë për gjelbërimin e qytetit ku Bashkia ka pasur si përparësi mbjelljen e sa më shumë pemëve në lagje të ndryshme të qytetit.

Deri më tani në Kamzë janë mbjell 105.874 pemëve të reja dekorative në territorin e kësaj Bashkie.

Q: Sa është vitalizuar qyteti nën drejtimin tuaj?

Kamza është një qytet vital. Ndryshe nga 11 vjet më parë, sot qytetarët e Kamzës kanë më

ku mund të ndjekin dhe zhvillojnë veprimtari kulturore veçanërisht nxënësit e shkollave, një palestër moderne basketbolli dhe stadiumin e ri ku mund të ndjekin ekipet e tyre të zëmërës në basketboll dhe futboll. Të dy ekipet kanë arritur suksese dhe janë ekipe elitare të sporteve shqiptare.

Q: Cilat janë disa nga problematikat që ka ky

një pallati sporti, ku kemi gati projektin dhe vendin për ta ngritur dhe do të jetë më i madhi dhe më i miri në vend.

Mjaft problematike janë edhe përmbytjet si pasojë e reshjeve. Është emergjente ndërhyrja në kolektorë dhe Bashkia ia ka parashtruar qeverisë, institucioneve të linjës si dhe vetë Kryeministrit financimin e kolektorit në Valias dhe kolektorit Zall-Herr – Bathore – Frutikulturë; pajisja me ekskavator, gjë që i ishte mohuar më parë nga ana e qeverisë si dhe pajisja e Kamzës me një stacion zjarrfikëseje, duke qenë se nuk e ka. Qytetarët e Kamzës u përballën me arbitraritetin e kësaj qeverie sa i përket aksionit për energjinë elektrike, ku, pa sqaruar de fakto sa energji është harxhuar, pra pa bërë sistemimin e kilovatëve, qeveria u sul mbi ta duke i arrestuar apo dhe faturuar sasi kilovatësh ta pakonsumuar. Plus kësaj, sot ende në territorin e Bashkisë Kamzë ka nevojë për investime në rrjetin elektrik. Një problematikë tjetër është edhe heqja nga skema e ndihmës ekonomike të familjeve të cilave realisht u takon, pasi plotësojnë kushtet. Vetëm këtë fillim viti Bashkisë Kamzë i janë hequr rreth 800 familje nga skema e ndihmës ekonomike, të hequra padrejtësisht (diskriminim politik). Nga viti 2013 deri sot janë hequr mbi 6 mijë familje nga skema e ndihmës ekonomike.

Q: Sa larg standardit të Tiranës gjendet sot Kamza?

Në fakt, pyetja duhej të ishte sa larg Kamzës është Tirana. Siç e theksova edhe më lart, Kamza ka njohur ndryshime rrënjësore në këto vite, veçanërisht prej 2007-s. Duke qenë zonë informale është bërë një punë mjaft e kujdesshme nga ana e institucionit Bashki për të investuar në çdo lagje, për t'i urbanizuar atë dhe për t'i kthyer ato në vitale për qytetarët. Kamza është një qytet që zhvillohet dita-ditës, kurse Tirana është zhbërë. Kaosi i asaj çfarë ka ndodhur në kryeqytet dhe fatkeqësisht me leje nga Bashkia, ka bërë që kryeqyteti të mos jetë i jetueshëm dhe në këtë njësi administrative, më e madhja në vend, të mbizotërojnë kullat. Kjo ka ndodhur me Edi Ramën kryebashkiak 11 vjet dhe po vijon edhe me Erion Veliajn, kur sot në qendër të debatit është ngritja e kullave ose siç quhen ndryshe qiellgërvishësit.

Q: Duket se prej vitesh qytetarët jua besojnë juve drejtimin e Kamzës. Çfarë kryebashkiaku është Xhelali?

Së pari, dua të falënderoj qytetarët për besimin që ma kanë dhënë në tri mandatet e drejtimin të Bashkisë Kamzë. Besimi i tyre ka qenë një detyrim për mua për të qenë sa më pranë tyre në ofrimin e shërbimeve dhe të investimeve.

Fakti që prej vitit 2007 qytetarët e Kamzës më kanë votuar sistematikisht mua si të zgjedhur vendor, është tregues i vlerësimit të punës së bërë në krye të Bashkisë.

E kam për kënaqësi që jam qytetar i



shumë mundësi, falë investimeve të Bashkisë. Prioriteti im si kryetar Bashkie ka qenë çuarja e investimeve kudo, duke mos i parë qytetarët politikisht bazuar mbi rezultatet zgjedhore. Kam investuar në çdo lagje në infrastrukturë, duke u dhënë mundësinë të kenë një jetesë më të mirë, të zhvillojnë bizneset, atyre që kanë mundësi. Para vitit 2007, bashkëqytetarët e mi përballëshin me situata të vështira: me rrugë me baltë dhe mungesë KUN-sh dhe aktualisht pjesa dërrmuese e tyre i kanë lagjet e urbanizuara dhe ndërkohë puna vazhdon me intensitet.

Qytetarët sot kanë një Pallat të ri Kulture,

qytet?

Pavarësisht nga zhvillimet e vullshme të ndodhura 11 vitet e fundit, sërish Kamza ka mjaft problematika që kërkojnë zgjidhje dhe që nuk janë në dorën e Bashkisë zgjidhjet, pasi realisht mungojnë edhe mundësitë financiare. Më konkretisht, nevojitet ndërtimi i 5 kopshteve të reja dhe rikonstruksioni i 3 të tjerëve, si dhe ndërtimi i 4 shkollave dhe po rikonstruksioni i 3 të tjerave, gjë që kërkon mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Duke pasur parasysh arritjet në sport të ekipeve të Kamzës në basketboll dhe futboll, është e nevojshme ndërtimi i



XHELAL MZIU MISIONI IM PËR KAMZËN

Xhelal Mziu është ndër liderët fjalëpikë. Pak gjëra mund t'i marrin vëmendjen e tij, por kjo deni kur përmendet Kamza. Kur flasim për qytetin që ai drejton prej 11 vitesh, kryebashkiaku ka shumë për të thënë. Investimet, projektet, idetë, problemet e këtij qyteti marrin menjëherë të gjithë përkushtimin e tij dhe ka shumë për të thënë. Duket se ky qytet, fare pranë Tiranës po ndryshon me ritme të shpejta dhe ky është misioni që Xhelal Mziu ka patur dhe ka këtto 11 vite në pozitën e Qytetarit të Parë. Në intervistën e tij për "Starpeople", kryebashkiaku rëfren impetrimet dhe sfidat që ndesh çdo ditë. Por krahas kësaj, Mziu rëfren për lexuesin edhe anën tjetër, si një njeri familjar dhe një prind i përkushtuar...

Ka qytet me mision të qytetarëve, si ka ndryshuar Kamza?
Kamza ka patur ndryshime të mëdha. Unë jam qytetar i Bashkisë që prej vitit 2007. Kur si të kalonim në kryebashkiak, situata ishte e vështirë për një qytet të vogël. Esha në vitin 2007 dhe në funksion prej vitit 2013, kur kam njësi Administrative në bashkië. Por si bashkiar menjëherë më të duhej të shprehja faktor të rëndësishëm, por jo të rëndësishëm të bashkisë dhe të përdorja të bashkisë. Në vitet që më përpara kam punuar në bashkië dhe për të parën planifikim. Në vitet që më përpara kam punuar në bashkië dhe për të parën planifikim. Në vitet që më përpara kam punuar në bashkië dhe për të parën planifikim.

“ Kamza është një qytet vital. Ndryshe nga 11 vitet e parë, sot qytetarët e Kamzës kanë më shumë mundësi, falë investimeve të Bashkisë...”

Bathores, jam vetëm një prej qytetarëve të Kamzës, i zgjedhur për të drejtuar Bashkinë dhe për t'u dalë zot halleve dhe problemeve të tyre.

Si i keni marrëdhëniet me qytetarët, jashtë detyrës të Bashkisë?

Marrëdhëniet e mia me qytetarët e Bashkisë Kamzë janë shumë të mira. Përveç pritjes së ditës së premtë, si ditë zyrtare ka personalisht

prodhuar politikë dhe këtë e kam bërë në interes të qytetarëve të Kamzës, gjë që e kam primare, të cilët më kanë besuar prej vitit 2007. Qeveria e ka detyrim të mbështesë bashkitë dhe ato nuk duhen parë me syrin politik. Sikurse Kryeministri edhe ne kemi marrë votën qytetare. Në Bashkinë Kamzë nuk ka vetëm votues demokratë, por edhe socialistë dhe të bindjeve të tjera. Për t'u përgjigjur pyetjes suaj, dua të them që po,

me projektet mbi tavolinë. Deri tani nuk është reflektuar. Nuk është bërë financimi i dy kolektorëve me vlerë 4 milionë euro: kolektorit në Valias dhe i kolektorit Zall-Herr – Bathore – Frutikuturë. Nuk është bërë pajisja me ekskavator e Bashkisë, si dhe pajisja e Kamzës me një stacion zjarrfikëse duke qenë se nuk e kemi, edhe pse ndodhet në Kodër-Kamzë. Qeveria as nuk ka dëmshpërbyer familjet e përmbytura.

ka qenë edhe në kushte të pabarabarta, ku ka pasur intimidim të zgjedhësve, tentativë për blerje të tyre, por rezultati në fund të garës ka qenë në favorin tim, për faktin se bashkëqytetarët e mi më kanë vlerësuar për atë çfarë kam bërë si i zgjedhuri prej tyre.

Kur nuk jeni kryebashkiak i Kamzës, si vijon jeta juaj, angazhimet, pasionet?

Gjatë kohës së lirë merrem me familjen, angazhimet në jetën shoqërore, merrem sport etj.

Çfarë babai është Xhelali, autoritar apo një mik i mirë?

Si çdo prind edhe unë mundohem dhe gjej kohën të jem pranë familjes. Përkushtimi im është maksimal ndaj tyre. Jam komunikues, këshillues ndaj fëmijëve dhe nuk shquhem për ashpërsi në familje.

Do të donit që fëmijët të ndiqnin rrugën tuaj në politikë?

Do të doja që fëmijët e mi të ishin të lirë në zgjedhjen e tyre. Nëse ata do të donit të merreshin me politikë, unë do t'i inkurajoja dhe do të jepja nga përvoja ime që ata të mund të jepnin më të mirën në këtë fushë. Jam shumë i kënaqur me rezultatet e tyre në mësimet dhe me sjelljen e tyre në shoqëri.

Cila është këshilla që u jep gjithnjë?

Unë i këshilloj të jenë të edukuar, të sjellshëm dhe komunikues në raport me çdokënd që kanë të bëjnë në jetë si dhe të



Pres qytetarët për t'i dëgjuar për hallet (por i takoj edhe ditëve të tjera), takohem me ta edhe në terren. Qytetarët janë pjesë e vendimmarrjes së Bashkisë për kryerjen e investimeve, me të cilët konsultohem nëpërmjet dëgjësave publike, si dhe kontaktoj çdo ditë në terren gjatë inspektimit të investimeve të Bashkisë.

Kamza si një Bashki e djathtë, sa "diskriminohet" nga qeveria e socialistëve?

Prej vitit 2013 Kamza është diskriminuar nga qeveria "Rama". Kemi mbi 137 projekte që flenë në sirtarë e ministrive dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigje. A nuk është absurde që bashkia e gjashtë më e madhe në vend nuk gjen mbështetjen e ekzekutivit?! Herë pas here kam akuzuar qeverinë për mosbashkëpunim, duke thënë vetëm të vërtetën, duke mos

jemi diskriminuar dhe jo vetëm politikisht madje. Një tjetër problem i Bashkisë, dhe do ta quaja diskriminim, është edhe moskalkimi i kompetencave me ndarjen e re territoriale bazuar në ligj.

A ka bashkëpunim mes jush dhe Kryeministrit Rama?

Bashkëpunimi nuk ka nevojë të jetë individual mes dy personash, pavarësisht nga pozita që ata kanë, por duhet institucional. Bashkëpunimi i Bashkisë Kamzë dhe imi si kryebashkiak nuk ka munguar asnjëherë. Ky bashkëpunim ka qenë përmes shkresave, por, realisht, zgjidhje nuk ka pasur nga ekzekutivi. Edhe në takimim e shkurtër që pata më Ramën në Kamzë, në rastin e përmbytjeve, i ritheksova të njëjtat nevoja që ka Bashkia, ato për të cilat ai dhe vartësit e tij kanë kërkesat



Na ndan thujt një vit nga zgjedhjet lokale. A do të rikandidojë Xhelal Mziu për një tjetër mandat?

Unë jam në detyrë si kryebashkiak dhe është ende herët të mendoj këtë gjë. Jam në politikë aktive jo vetëm si kryebashkiak, por edhe si kreu i degës së PD-së Kamzë. Në atë çfarë kam dhënë kam qenë rezultativ dhe për këtë bashkëqytetarët e mi më kanë besuar, duke votuar për mua si kryebashkiak prej vitit 2007 si dhe PD-në në çdo palë zgjedhje parlamentare. Unë vazhdoj të jem kontribuues aktiv në politikë dhe do të vazhdoj të jem.

Keni krijuar tashmë mitin e personit të pathyeshëm në Kamzë. A keni rivalë?

Në çdo garë kam qenë me rivalë, pavarësisht se qytetarët më kanë besuar mua. Madje, gara

mësojnë në shkollë e të japin më të mirën sot dhe në të ardhmen.

E keni menduar ndonjëherë veten, nëse nuk do të angazhoheshit në politikë, cili do të ishte sot Xhelal Mziu?

Në fakt, pas rënies së komunizmit, ku personalisht kam qenë pjesë e Lëvizjes së Dhjetorit, gjëja e vetme që më ka shkuar në mendje ishte të merresha me politikë dhe të jepja më të mirën nga vetja për bashkëqytetarët e mi. Edhe nëse nuk do të merresha me politikë, unë do të isha një ekonomist i zoti, ku edhe pse në politikë, kam investuar në këtë profesion. Tashmë politika është kthyer në një profesion për mua, pas jetës akademike (pasi unë kam puthuajse 10 vite në UBT) dhe jam në proces të marrjes së titullit "Profesor i Asociuar".



Vijojnë punimet në sheshin e ri në qendër të qytetit

Vijojnë punimet në sheshin e ri në qendër të qytetit të Kamzës. Ndër projektet e Bashkisë që po realizohen këtë vit, është edhe ndërtimi i sheshit të ri në qendër të qytetit, pranë Pallatit të Kulturës, me sipërfaqe 3936 metra katrorë. Ky është një nga investimet e shumta që janë pjesë e financimeve të Bashkisë Kamëz.

Zbatimi i këtij projekti përbën fazën e parë të ndryshimit të pamjes së qytetit, e cila promovohet në një kohë kur Bashkia është në një fazë të zbatimit të shumë projekteve që kanë lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetesës së qytetarëve të Kamzës. Përveç gjelbërimit (që përfshin mbjelljen e pemëve dekorative dhe luleve) dhe ndriçimit të bollshëm do të ketë një shatërvan, çezmë uji, kosha mbeturinash etj. Kjo tregon edhe një herë vizionin e qartë që ka kreu i Bashkisë, z. Xhelal Mziu, për intensifikimin e punës për t'u ofruar qytetarëve investime të dobishme publike dhe shërbime cilësore dhe korrekte për ta.

Ky projekt ishte gati dhe punimet mund të nisnin për t'u



realizuar kohë më parë, teksa Bashkia priste financim nga qeveria, me qëllim që fondet e buxhetit me të ardhurat e veta të shkonin për të tjera investime në qytet. Pavarësisht nga shkresat



me 137 projekte konkrete të dërguara në qeveri, Edi Rama nuk ka financuar asnjë, duke i diskriminuar politikisht banorët e Kamzës.

Një sërë segmentesh rrugore me gjatësi 720 metra linearë do të ndërtohen në lagjen 1 Bathore

Bashkia Kamëz ka planifikuar që në vitin 2018 të ndërtojë në këtë lagje: rrugën "Arras", rrugën "Horizonti", rrugën "Kaltërsia" (vazhdimin + rruga "Bulqiza", segment i Rrugës së Arbrit)

Një sërë segmentesh rrugore me gjatësi 720 metra linearë do të ndërtohen në lagjen 1 Bathore: rruga "Arras", rruga "Horizonti", rruga "Kaltërsia" (vazhdimi + rruga "Bulqiza", segment i Rrugës së Arbrit).

Bashkia Kamëz ka planifikuar që në vitin 2018 të përmirësojë ndjeshëm infrastrukturën rrugore edhe në këtë zonë. I gjithë investimi do të financohet nga vetë Bashkia, pavarësisht nga



vështirësitë e hasura në këto pesë vite, për shkak të indiferencës së qeverisë.

Edhe pse vijon ky diskriminim i Kryeministrit ndaj qytetarëve të Kamzës, të cilët janë shtetas shqiptarë që meritojnë investime si gjithë pjesa tjetër, Bashkia ka përdorur çdo instrument për të realizuar investime në dobi të komunitetit të banorëve.

Shembull konkret janë qindra projekte jetikë për qytetarët, që janë shtrirë në të gjitha lagjet e qytetit.

Ky ritëm do të vazhdojë vit pas viti, me qëllimin për të qenë sa më afër banorëve, me shërbime dhe investime.

Rruga "Abaz Shehu", një investim tjetër i Bashkisë Kamëz për vitin 2018 në lagjen Paskuqan 2, Vresht



434 metra linearë dhe gjerësi 6 metra do të ketë rruga "Abaz Shehu" në lagjen Paskuqan 2, Vresht.

Ndërtimi i kësaj rruge është një tjetër projekt i Bashkisë Kamëz për vitin 2018, i financuar nga buxheti i saj. Janë rreth 70 projekte që po realizohen në territorin e Kamzës, falë mundësisë së mirëmenaxhimit të të ardhurave nga vetë Bashkia.

Kjo, në një kohë kur nga ana e qeverisë së majtë për pesë vite me radhë nuk është akorduar asnjë qindarkë për qytetarët e Kamzës.

Duke marrë shkas nga kjo politikë diskriminuese e qeverisë, Bashkia Kamëz ka shfrytëzuar çdo burim dhe instrument për të krijuar të ardhura, të cilat kthehen në investime dhe shërbime për qytetarët e Kamzës.

Një tjetër investim i Bashkisë nis së shpejti, ndërtimi i rrugës "Dedë Gjo Luli" dhe i degëzimit të rrugës "Arben Broci" në Paskuqan Fushë



Një tjetër investim i Bashkisë nis së shpejti, ndërtimi i rrugës "Dedë Gjo Luli" dhe i degëzimit të rrugës "Arben Broci" në Paskuqan Fushë. Një tjetër investim i Bashkisë Kamëz që nis së shpejti, është ndërtimi i rrugës "Dedë Gjo Luli" dhe i degëzimit të rrugës "Arben Broci" në Paskuqan Fushë, me gjatësi 600 metra linearë. Pas realizimit të këtij investimi, banorëve të zonës do t'u shtohet edhe një tjetër element bashkëkohor i infrastrukturës urbane. Ky ka qenë edhe një prej premtimeve të bëra realitet nga kryebashkiaku Xhelal Mziu, urbanizimi i Paskuqanit. Në tre vite buxhetore të Bashkisë, pjesa dërrmuese e fondeve ka shkuar për të ndërtuar një infrastrukturë, e cila mungonte më parë në këtë njësi administrative. Janë me dhjetëra projekte që janë realizuar në lagjet e Paskuqanit, të cilat u vijnë në ndihmë mijëra qytetarëve. Rruga "Dedë Gjo Luli" dhe degëzimi i rrugës "Arben Broci" në Paskuqan Fushë, me gjatësi 600 metra, do të ketë gjerësi 6 m.

Përfundon procedura e prokurimit, lidhet kontrata për nisjen e ndërtimit të rrugës "Myslym Shyri" në Babrru



Ka përfunduar procedura e prokurimit për ndërtimin e rrugës "Myslym Shyri" në Babrru, Kodër e Kuqe. Ky investim financohet tërësisht nga të ardhurat e Bashkisë Kamëz. Projekti që po realizohet në këtë zonë, ka gjatësi prej 224 metrash linearë, do të ketë rrjet të kanalizimeve të ujërave të bardha, ku do të përdoren tuba me përmasa Ø 315 mm. Gjithashtu, gjerësia e saj do të jetë 5 m, me kunetë anash 0.5 m. Me këtë ritëm të investimeve, Bashkia Kamëz vijon realizimin e projekteve të rëndësishme në infrastrukturën urbane të qytetit. Mes dhjetëra projekteve të parashikuara të zbatohen këtë vit dhe të tjerave që janë në zbatim, është edhe ndërtimi i rrugës "Myslym Shyri", bashkë me kanalizimet e ujërave të bardha. E rëndësishme është se të gjitha investimet financohen vetëm nga të ardhurat e Bashkisë, për arsye se nga ana e qeverisë nuk është dhënë asnjë fond për projektet në dobi të qytetarëve të Kamzës.



Drejtorja e Taksave dhe e Tarifave Vendore, e motivuar për të realizuar objektivat

Drejtorja e Taksave dhe e Tarifave Vendore ka vijuar punën për të harmonizuar aksionin për mbledhjen e detyrimeve për subjektet private si dhe duke realizuar në terren njoftimet për taksat familjare. Është një periudhë ku inspektorët e drejtorisë kanë operuar me subjektet, të cilat nuk kanë shlyer detyrimet sipas njoftimeve të bëra në fillim të vitit 2018 dhe të mbyllura si njoftime tatimore deri më 20 prill 2018 sipas parashikimeve që u jep ligji përkatës.

Duhet përmendur që kemi një shifër rreth 60-65 % të të ardhurave të realizuara nga biznesi deri në 31 maj 2018 dhe pothuaj me



të njëjtën shifër janë të ardhurat e realizuara nga taksat familjare për periudhën 5-mujore. Të ndodhur përpara këtyre fakteve Drejtorja e Taksave dhe e Tarifave Vendore ka nisur pikërisht punën për të marrë kontaktet e drejtpërdrejta në terren pikërisht për të bërë të mundur si detyrimet e mbartura për vitin 2018 në respekt të zbatimit të ligjit në funksion të paketës fiskale, ashtu edhe për detyrimet e prapambetura të pashlyera deri më sot nga çdo subjekt për të realizuar një buxhet, i cili është planifikuar që më shumë se 60 % e tij të shndërrohet në investime për qytetarët e Kamzës.

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve vlerësohet nga KfW lidhur me auditin financiar për fazën V të projektit të ujësjellësit

Përfaqësues të KfW-së kanë realizuar auditin financiar për fazën V të projektit "Infrastruktura Bashkiake", prej të cilit është përfituar investimi në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm në territorin e Bashkisë Kamëz.

Ekspertja financiare pranë KfW-së, znj. Verena Pfeiffer, dhe koordinatori i projekteve të huaja, përfaqësues i kompanisë "Setec", z. Laert Shehu, ishin në Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz në një takim që lidhet me informacionin, ecurinë financiare dhe parametrat e tjerë teknikë të kësaj ndërmarrjeje. Stafi drejtues i Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve, pasi vuri në dispozicion dokumentacionin e grumbulluar me të dhëna rreth menaxhimit financiar të deritanishëm të ndërmarrjes, iu përgjigj kërkesave të bëra nga ana e ekspertës financiare të KfW, znj. Pfeiffer, duke i bërë me



dije pritshmëritë, nevojat si dhe objektivat për funksionimin e mëtejshëm të Ndërmarrjes së Ujësjellës-Kanalizimeve. Znj. Pfeiffer u shpreh mjaft premtuese si dhe evidentoi arritjet në performancën më të mira lidhur me një vit më parë.

Si përfaqësuese e KfW-së, ajo garanto mbështetje të mëtejshme. Gjatë ditëve do të hartojë një raport lidhur me vlerësimin financiar dhe pasqyrat sipas leximit dhe manualit të KfW-së.

Vazhdon puna në terren për vjeljen e detyrimeve të prapambetura

Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve Kamëz ka vazhduar punën në terren edhe në ditët e nxehta të qershorit. Puna është organizuar në grupe pune sipas sektorëve: Kamëz, Bathore dhe Paskuqan.

Kryesisht është punuar për vjeljen e detyrimeve të prapambetura, ndërkohë që janë marrë masa deri në ndërprerjen e furnizimit me ujë të abonentëve debitorë që nuk kanë shlyer detyrimet ose që nuk kanë nënshkruar aktmarrëveshje me ujësjellësin.

Edhe në periudhën e muajit të qershorit Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve ka intensifikuar masat për përqendrimin e punës për përbalimin e situatave të vështira që përcakton kjo periudhë e nxehtë verore.

Punonjësit e saj janë impenjuar maksimalisht për të rritur ofruar shërbim cilësor për qytetarët, duke e rritur ritmin e punës dhe përgjegjësinë për përmbushjen e objektivave. Këtë e ka kërkuar edhe kryebashkiaku Xhelal Mziu, që shërbimi i Ndërmarrjes së Ujësjellësit ndaj qytetarëve të jetë në lartësinë e duhur.

Punonjësit e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, të fokusuar në punën për mirëmbajtjen e varrezave të qytetit



Ka vijuar puna për mirëmbajtjen e varrezave dhe duke rritur shkallën e shërbimit në këtë sektor. Është kjo një nga detyrat funksionale të Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit, për të rritur të gjithë përgjegjësinë në këtë shërbim mjaft të ndjeshëm për qytetarët.

Gjatë kësaj periudhe, punonjësit e kësaj ndërmarrjeje kanë qenë të angazhuar për mirëmbajtjen e të gjitha varrezave.

Kjo ndërmarrje administron, ruan dhe menaxhon varrezat në Bathore, Laknas, Kamëz, Kodër e Kuqe dhe Babrru. Konkretisht, janë kryer pastrime dhe aksione të vazhdueshme për mirëmbajtjen

e tyre. Grupet e punës të ngritura nga ana e ndërmarrjes kanë bërë ndarjen në parcela dhe rreshta, dhe është bërë ndarja me bordura e varrezave, sipas mënyrës së sistemit në parcela.

Minimizimi i sipërfaqes së tokës të planifikuar për këtë lloji shërbimi është një problem mjaft social dhe ka vështirësuar deri në njëfarë shkalle shërbimin me rastet e vdekjeve që

kanë ndodhur gjatë vitit 2018.

Kjo ka bërë që Bashkia të marrë masa konkrete, duke inventarizuar hapësirat e mbetura për këtë shërbim në të gjitha varrezat që janë të ndërtuara në territorin e Bashkisë Kamëz, duke i vendosur strukturat e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit për marrjen e përgjegjësisë, për kërkesë për shtimin e hapësirave për varrime.

Gjithashtu nga ana e Bashkisë po merren të gjitha masat e duhura për të gjetur hapësira për të krijuar parcela të reja për shërbime varrimi.

Në Pallatin e Kulturës Kamëz, shfaqja "Bon-Boni në mbretërinë e ëmbëlsirave", me pjesëmarrjen e Marjana Kondit



Në Pallatin e Kulturës Kamëz është vënë në skenë shfaqja me mesazhe ndërgjegjësuese "Bon-Boni në mbretërinë e ëmbëlsirave", organizuar nga "World Vision Albania", me pjesëmarrjen e aktorese së mirënjohur Marjana Kondi. Si nismë e qeverisë së nxënësve të shkollave në Bathore të mbështetur nga organizata "World Vision Albania", kjo shfaqje kishte për qëllim sensibilizimin e fëmijëve, edukimin, përcjelljen e mesazheve, duke i kthyer fëmijët në faktor kryesor nëpërmjet

elementit artistik. Ndershmëria, diversiteti, mirënjohja, admirimi, përjashtimi social dhe dashuria ishin fokusi i këtij aktiviteti. Ndryshe nga organizimet e mëparshme, fëmijët nuk predikonin mesazhe të induktuara nga të tjerët, por përcollën për bashkëmoshatarët e tyre përvoja jetësore përmes gjuhës së teatrit. Ata interpretuan përkrah një trupe profesioniste dhe aktorese së mirënjohur Marjana Kondi, duke garantuar kështu një brez të ri artistësh të dalë nga qyteti ynë.



Kryebashkiaku Mziu, i ftuar në panelin 2 të programit “Bashkitë/ qytetet urbane inteligjente dhe industrinë e energjisë 2018”

Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Xhelal Mziu, ishte i ftuar në panelin 2 të programit “Bashkitë/qytetet urbane inteligjente dhe industrinë e energjisë efçente 2018”. Ky aktivitet organizohej nga Ambasada e Danimarkës.

Në panelin 2 të programit, me titull “Planifikimi urban, lëvizshmëria dhe mirëqenia”, ku diskutoi edhe kryebashkiaku Mziu, merrnin pjesë gjithashtu edhe znj. Majlinda Bufi, kryetare e Bashkisë



Roskovec; znj. Adelina Greca, drejtore e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit; z. Daniel Mitchel, zëvendëspresident për Zhvillimin Ndërkombëtar të Biznesit - Smart City, Deutsche Telekom; znj. Irida Vela, partnere drejtuese, SAM International Albania; z. Bujar Spahija, drejtor i Përgjithshëm, Novo Nordisk, Shqipëri. Tema kryesore e programit “Bashkitë/qytetet urbane inteligjente dhe industrinë e energjisë efçente 2018” është

gjetja e zgjidhjeve për qytetet “smart” (inteligjente). Bëhet fjalë për bashkitë/qytetet inteligjente dhe industrinë efikase për energji. Kjo është arsyeja e ftesës për njësitë e qeverisjes vendore, për kompanitë e shërbimeve publike dhe kompanitë që punojnë me projekte bashkiake, me qëllim për të ndarë praktikat më të mira. Qëllimi i veprimtarisë ishte të shfaqeshin dhe të diskutoheshin për arritjet shqiptare dhe daneze në organizimin dhe drejtimin e bashkive/qyteteve “smart”.

Asambleja e Rajoneve Evropiane, AER, publikon kërkesën e Bashkisë Kamëz për partneritet në projekte

Asambleja e Rajoneve Evropiane (The Assembly of European Regions - AER) ka publikuar në faqen zyrtare të saj një artikull për Kamzën dhe kërkesën e Bashkisë për partneritet në projekte. Në artikullin e publikuar në këtë faqe thuhet se Kamza ndodhet 7 km larg kryeqytetit, Tiranës, dhe është qyteti i gjashtë më i madh në Shqipëri. Pozita gjeografike e këtij qyteti është më e favorshme në trekëndëshin strategjik: Tiranë - aeroporti ndërkombëtar “Nënë Tereza” - Durrës. Ndërkaq, në artikull theksohet se Kamza ka përvojë të mëparshme të rëndësishme në projektet e financuara nga BE, veçanërisht në kuadër të programit IPA Adriatic Cross-border Cooperation Programme, partner në Projektin BWS314 “Build Waste Sustainability: New Capacities for a Sustainable Waste Management”, që kishte për qëllim ndërtimin e kapaciteteve vendore në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Asambleja e Rajoneve Evropiane (The Assembly of European Regions - AER) është rrjeti më i madh i pavarur i rajoneve në Evropë, duke mbledhur rajone nga 35 vende - nga Norvegjia në Turqi dhe nga Rusia në Portugali. AER është e pranishme kudo në kontinentin evropian, brenda dhe jashtë



Bashkimin Evropian. AER është vendi për palët e interesuara rajonale në kontinentin evropian: politikanët, zyrtarët, ekspertët, këshilltarët dhe promovon një Evropë që përfshin diversitetin e saj për të lulëzuar në një botë globale. AER është zëri i autoriteteve rajonale që nga viti 1985 dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në njohjen e rajoneve si aktorë kryesorë. AER beson se një Evropë e suksesshme, shumëkulturore dhe shumëgjuhësore shkon krahas me rajonet e suksesshme. Rajonet anëtare të AER janë gur themeli i organizatës. AER mbështet në përfshirjen e anëtarëve, nëpërmjet politikave dhe nëpunësve civilë, për të mbajtur rrjetin aktiv dhe relevant. Koha dhe burimet e AER-së harxhohen për të kuptuar shumëllojshmërinë e anëtarëve, nevojat e tyre dhe për të siguruar që të

ofrohen shërbime cilësore në dobi të tyre. AER ka aftësinë për të sjellë shikueshmëri tek anëtarët individualë dhe politikanët dhe për të promovuar punën, veprimet dhe aktivitetet e tyre. Ajo mat suksesin si një rrjet në lidhjen e rajoneve me njëri-tjetrin, duke qenë ndërlidhja e tyre dhe duke ndërtuar ura për bashkëpunim ndërrajonal.

Matja e vlerës së shtuar

AER përpiqet çdo ditë për të plotësuar nevojat e rajoneve anëtare, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve. AER ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh duke qenë e vetëdijshme për nevojën e rajoneve për të justifikuar anëtarësimin e tyre në rrjetet e tilla.

Një model i hapur dhe transparent anëtarësimi

Anëtarësimi dhe partneriteti është i hapur për një gamë të gjerë të subjekteve gjeografike dhe jogjeografike në frymën e “përqafimit” të potencialit të bashkëpunimit në Evropë dhe më gjerë.

• **Anëtarët e plotë janë:** 1) rajonet evropiane, me kusht që ata të respektojnë parimet themelore të Këshillit të Evropës ose 2) grupe rajonesh brenda një shteti, përveç nëse të gjithë anëtarët e një grupi të tillë tashmë i përkasin AER-së në baza individuale.

• **Anëtarët e asociuar janë:** 1) entitete

territoriale evropiane dhe joevropiane, organizata ose shoqata, duke përfshirë ndarjet administrative nën nivelin kombëtar ose rajonal ose 2) organizatat themeluese të AER, shoqatat ndërrajonale të rajoneve evropiane.

• **Vëzhguesit,** për një kohë të kufizuar, janë: çdo subjekt që dëshiron të mbikëqyrë AER-në para se të bashkohet si anëtar i plotë ose i asociuar.

Termi “Rajon” mbulon në parim autoritetet territoriale midis qeverisë qendrore dhe autoriteteve lokale, me një fuqi përfaqësimi politik të ngarkuar nga një asamble e zgjedhur.

• **Rrjetet partnere** janë rrjetet e rajoneve të fokusuar në një fushë specifike tematike dhe / ose gjeografike. Ata kontribuojnë në punën e Asamblesë së Rajoneve Evropiane, duke i mbajtur anëtarët e saj të përditësuar në një gamë të gjerë temash, ndërsa ata lehtësisht mund të shpërndajnë informacion dhe të rrisin ndërgjegjësimin në të gjithë rrjetin.

• **Partnerët privatë,** AER propozon partneritete të favorshme duke lidhur kompanitë me botën rajonale. Ndërsa bizneset mund të ndajnë vizionin e tyre në fushën e tyre të njohurive, AER lehtëson qasjen tek vendimmarrësit rajonal dhe vepron si një qendër për kompanitë brenda rrjetit të gjerë rajonal.

Bashkëpunimi i Bashkisë Kamëz me “Qatar Charity”, ndihma për familjet në nevojë



këtë mbështetje kanë qenë të përfshira edhe familje të komunitetit rom dhe egjiptian që jetojnë në territorin e Bashkisë Kamëz dhe që tashmë janë të evidentuara, duke i përfshirë në skemat e ndihmës. Duke i lënë jashtë

Bashkia Kamëz në bashkëpunim me organizatën “Qatar Charity” kanë mbështetur ndihma ushqimore familjet më në nevojë të qytetit të Kamzës. Janë mbi 300 familje që kanë përfituar nga këto ndihma, kryesisht në ushqime. Edhe pse janë hequr nga ana e qeverisë padrejtësisht me qindra familje nga skema e ndihmës ekonomike, Bashkia ka vazhduar iniciativën e saj që të jetë pranë këtyre familjeve në nevojë. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar partneritetet me organizata dhe shoqata ndihmëse që operojnë në fushën e ndihmave humanitare për shtresat në nevojë. Në

vëmendjes të tilla familje në nevojë, qeveria qendrore rrit shkallën e indiferencës ndaj tyre dhe përtej saj nuk shikohet asnjë strukturë e institucioneve qendrore që të shtrijnë dorën e bashkëpunimit për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit të ardhjes në ndihmë ndaj këtyre familjeve në nevojë. Kryebashkiaku Xhelal Mziu ka orientuar të gjitha strukturat funksionale të Bashkisë që të kenë gjithë vëmendjen e duhur dhe gatishmërinë e plotë për t'u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë që jetojnë brenda territorit të Kamzës.

Takim në kuadër të projektit “Rrisim kapacitetet e ofruesve të shërbimeve për gratë viktime të të gjitha formave të dhunës”

Projekti financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women

Në mjediset e Pallatit të Kulturës Kamëz u zhvillua një takim në kuadër të projektit “Rrisim kapacitetet e ofruesve të shërbimeve për gratë viktime të të gjitha formave të dhunës në bashkitë e Kamzës dhe Lezhës”. Projekti financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women. Rritja e kapaciteteve për ofrimin e këtij shërbimi arrihet nëpërmjet

Mekanizmit të Referimit, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë: ndjekja e rastit dhe plotësimi i nevojave të viktimës së dhunës në familje duke siguruar edhe adresimin në shërbimet e përshtatshme; koordinimi dhe mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve; menaxhimi i rasteve të dhunës; shkëmbimi i të dhënave të rasteve konkrete ndërmjet institucioneve; monitorimi i mënyrës së funksionimit të të gjithë sistemit si dhe raportimi në institucionet eprorë.

Institucionet përgjegjëse për funksionimin e Mekanizmit të Referimit janë: Bashkia, e cila luan rol drejtues në ngritjen, konsolidimin, monitorimin dhe vazhdimësinë e mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës; komisiariati i policisë, qendrat shëndetësore,



Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, zyra e Ndihmës Ekonomike, zyra vendore e Punësimin, drejtoritë arsimore, organizatat jofitimprurëse. Ndërkaq, anëtarët e Mekanizmit të Referimit janë një grup teknik ndërdisiplinor që mbikëqyr dhe koordinon ofrimin e shërbimeve si dhe kryen menaxhimin e rasteve konkrete të dhunës në familje. Në janar të këtij viti, Qendra të Drejtat e Njeriut në Demokraci ka nisur zbatimin e projektit “Rritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve të Bashkisë Kamëz dhe Lezhës për gratë/vajzat e prekura nga të gjitha format e dhunës”, i cili financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women.